

RELACION SHPJEGUES PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR MIRATIMIN E LISTËS ME PËRBËRËSIT KRITIK DHE PJESËT E NDJESHME TË RRJETEVE 5G”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektakti “Për miratimin e listës me përbërësit kritik dhe pjesët e ndjeshme të rrjeteve 5G”, vjen si propozim i Ministrit për Infrastruturën dhe Energjinë, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 55 të ligjit Nr.54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Ky projektakt ka për qëllim të miratojë listën me përbërësit kritik dhe pjesët e ndjeshme të rrjeteve 5G, duke marr parasysh rëndësinë e sigurisë së rrjeteve 5G në zhvillimet digjitale dhe përdorimin e aplikimeve të bazuara në këto rrjete. Projekti ka si qëllim plotësimin e kuadrit nënligjor që del i nevojshëm në zbatim të Ligjit Nr.54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe gjithashtu harmonizimin me Rekomandimin e Komisionit Evropian (EU) 2019/534 të datës 26 Mars 2019 “Siguria kibernetike e rrjeteve 5G”, e njohur si 5G *Toolbox* për sigurinë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është parashikuar në Planin Analitik të akteve për vitin 2025, dhe do të parashikohet në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2025 – 2027, i cili është në proces përgatitje. Projektvendimi lidhet me zbatimin e ligjit Nr.54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” si dhe permbushjen e rekomandimeve të Bashkimit Evropian të dhënë në piketat përmbyllëse të Kapitullit 10.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji Nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka transpozuar Direktivën (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike”, në pikën 3 të nenit 55, ka parashikuar miratimin e listës me përbërësit kritik dhe pjesëve të

ndjeshme të rrjeteve 5G ose të gjeneratës së re të rrjeteve të tjera të komunikimit elektronik me vendim të Këshillit të Ministrave. Përcaktimi i elementeve kritike dhe të ndjeshme të rrjetit 5G, do të shërbejë për analizën e profilit të rrezikut të furnitorëve që është parashikuar në nenin 55 të ligjit Nr.54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Me anë të projektvendimit “Për miratimin e listës me përbërësit kritik dhe pjesët e ndjeshme të rrjeteve 5G”, synohet zbatimi i Rekomandimit të Komisionit Evropian (EU) 2019/534 të datës 26 Mars 2019 “Siguria kibernetike e rrjeteve 5G”, 5G *Toolbox* si dhe adresimi i rekomandimeve në kuadër të procesit të integritetit me piketat mbyllese të Kapitullit 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media”.

Miratimi i kësaj liste është në përputhje me parashikimin e pikës 3, të nenit 55 të ligjit Nr.54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Miratimi i listës me përbërësit kritikë dhe pjesët e ndjeshme të rrjeteve 5G të rrjeteve të komunikimit elektronik shërben për zbatimin e masave që lidhen me garantimin e sigurisë kombëtare dhe integritetit të infrastrukturës digjitale në vendin tonë. Kjo listë e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave bëhet edhe më e rëndësishme gjatë procesit të shtrirjes së teknologjisë 5G në vend, e cila do të përbëjë bazën për zhvillimin e shërbimeve që kanë nevojë për kapacitet dhe shpejtësi shumë të larta në të gjitha sektorët strategjikë të vendit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 55 të ligjit Nr.54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi është përafruar pjesësisht me Rekomandimin e Komisionit Evropian (EU) 2019/534 të datës 26 Mars 2019 “Siguria kibernetike e rrjeteve 5G”, 5G *Toolbox*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektakti përmban dy nene ku me nenin 1, parashikohet miratimi i listës me përbërësit kritik dhe pjesët e ndjeshme të rrjeteve 5G sipas tekstit të aneksit që i bashkelidhet këtij vendimi dhe nenin 2, që përcakton autoritetet përgjegjëse për ndjekjen e zbatimit të tij.

Dokumenti bashkëlidhur projektvendimit që përcakton listën me përbërësit kritik dhe pjesët e ndjeshme të rrjeteve 5G, është i organizuar me 4 pika si më poshtë:

Në pikën 1, parashikohen pjesët kritike dhe të ndjeshme të rrjeteve 5G ku përcaktohet rrjeti bërthamë (Core Network), rrjeti i aksesit radio (RAN), rrjeti i transmetimit dhe sistemet e menaxhimit dhe kontrollit. Në këtë përcaktim është mbajtur parasysh rekomandimet e 5G *Toolbox* për sigurinë, eksperiencat e vendeve të BE-së që kanë zbatuar 5G *Toolbox*. Për projektaktin janë zhvilluar dhe konsultime me operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike të rrjeteve celulare për të saktësuar listën e elementeve kritik që lidhen me zbatueshmërinë e sigurisë në rrjetet 5G. Kjo listë do shërbejë për analizen e profilit të rrezikut të furnitorëve siç parashikohet në nenin 55 të ligjit nr. 54/2024.

Në pikën 2, jepet lista e detajuar e përbërësve kritikë të rrjetit 5G, duke u bazuar në funksionet e elementeve kryesore të tyre si dhe bëhet vlerësimi i nivelit të rrezikut që ato paraqesin për sigurinë e rrjetit bazuar në rekomandimet e 5G *Toolbox* për sigurinë. Tabela ka bërë klasifikimin e elementeve të rrjetit nën grupimin/kategorinë: bërthama e rrjetit (Core Network), menaxhimi i NFV dhe orkestrimi i rrjetit (MANO), sistemet mbështetëse, rrjeti i aksesit radio (RAN) etj. Secili prej këtyre komponentëve është vlerësuar sipas nivelit të rrezikut (kritik, i lartë, ose i moderuar), duke theksuar funksionet kyçe që lidhen me autentifikimin, menaxhimin e përdoruesve, sigurinë, faturimin etj. Ky klasifikim është i nevojshëm për të identifikuar pikat më të ndjeshme të infrastrukturës 5G dhe për të ndihmuar autoritetet AKEP dhe AKSK si dhe operatorët në zbatimin e masave të duhura të sigurisë.

Në pikën 3, parashikohet që kërkesat për informacion për elementët kritike ose të ndjeshme të rrjetit 5G, sipas këtij vendimi i drejtohen operatorëve të rrjeteve celulare (MNO) dhe për atë që është e zbatueshme dhe operatorëve të rrjetet virtuale celulare (MVNO).

Në pikën 4, theksohet se pavarësisht përcaktimeve të bëra në pikat 1 dhe 2 më sipër, AKEP dhe AKSK kanë të drejtë të kërkojnë informacion shtesë për

funksiione ose pajisje të tjera që, ndonëse nuk janë përmendur shprehimisht, mund të konsiderohen si kritike ose me ndjeshmëri të lartë për rrjetet 5G apo rrjetet e ardhshme të komunikimit elektronik, si pasojë e zhvillimeve të reja teknologjike.

Formulimet e pikave të mësipërme 1,2 dhe 3 janë në përputhje dhe të harmonizuara me parashikimet e Rekomandimin e Komisionit Evropian (EU) 2019/534 të datës 26 Mars 2019 “Siguria kibernetike e rrjeteve 5G”, 5G Toolbox.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektakti ngarkohet MIE, AKEP dhe AKSK.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga stafi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me AKEP dhe AKSK, duke u bazuar në Rekomandimin e Komisionit Evropian (EU) 2019/534 të datës 26 mars 2019 “Siguria kibernetike e rrjeteve 5G”, e njohur si *5G Toolbox* si dhe eksperiencat e vendeve të BE-së që kanë zbatuar këtë rekomandim.

Në kuadër të hartimit të këtij akti, janë zhvilluar gjithashtu tre takime konsultimi me operatorët e rrjetit 5G.

Projekt vendimi do të dërgohet për mendim përmes e-akteve tek Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria se Kulturës Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociatori.

Projekt akti do te dërgohet për mendim me shkresë pranë AKEP dhe AKSK si dhe do të konsultohet përmes faqes së MIE.

Gjithashtu projektakti do të konsultohet përmes faqes zyrtare të MIE-s me aktort e interesuar.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektakti nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

DHE

MINISTËR

Belinda Balluku